

Liria e lëvizjes në tranzicion

2022



1.

Asociacioni i Komunave Serbe në Limbon e Marrëveshjeve të Papërbushura

2.

Loja e numrave: Zgjidhja e çështjes së personave të zhdukur 20 vjet më vonë

3.

Një tjetër mollë sherri: KOS në Dialogun për Normalizimin e marrëdhënieve

4.

Furnizimi me energji elektrike në veri të Kosovës

5.

Privatizimi në Kosovë nga këndvështrimi i komunitetit Serb

6.

Liria e lëvizjes: Episoda stiker

Titulli i hulumtimit: Liria e lëvizjes në tranzicion

Botues: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
– KFOS

Për botuesin: OJQ Aktiv

Autori: Sasha Illiq

Gjuha origjinale në të cilën është hartuar analiza është gjuha serbe.

Dizajn: tedel

Shtypshkronja (Tirazhi): 80

Ky botim u realizua në kuadër të projektit OPEN të implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) në bashkëpunim me organizatën OJQ Aktiv. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS-it.

Viti i botimit: 2022

PËRMBAJTJA

Rreth Nismës Open 07

PARTNERËT E
PROJEKTIT 08

RRETH RAPORTIT 08

01.

PËRMBLEDHJE
EKZEKUTIVE 09

02.

RETROSPEKTIVA
HISTORIKE DHE
SOCIO-POLITIKE E
LIRISË SË LËVIZJES
NË KOSOVË NGA
KËNDVËSHTRIMI I
KOMUNITETIT SERB 10

03.

LIRIA E LËVIZJES
NË KUADËR
TË DIALOGUT
NDËRMJET
BEOGRADIT DHE
PRISHTINËS 13

04.

HULUMTIMI MBI
TEMËN E LIRISË SË
LËVIZJES 17

05.

KONKLuzionet
KYÇE 23

06.

REKOMANDIME 24

07.

SHTOJCAT 26

Rreth Nismës Open

“Demokracia, hapja dhe perspektiva e komunitetit serb në Kosovë - OPEN” është një nismë e re e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), e filluar në vitin 2020. Kjo nismë ka për synim të zhvillojë një hapësirë të hapur dhe dinamike për diskutim brenda komunitetit serb, në mes të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera, si dhe institucioneve në Kosovë.

Organizatave të shoqërisë civile dhe mediat nga komuniteti serb në Kosovë, anëtare të nismës, në mënyrë specifike merren me analiza dhe vlerësime të ndikimit të organizatave civile dhe politike në zhvillimin e demokracisë, si dhe në hapjen e komunitetit serb në Kosovë. Përmes këtyre analizave vlerësohet se sa janë të hapura institucionet, politikat publike dhe proceset e rëndësishme ndaj komunitetit serb në Kosovë, si dhe vlerësohet shkalla e hapjes së komunitetit serb ndaj tyre.

Këto analiza do të ndihmojnë që të kuptohet gjendja aktuale dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë, përdorura në të njëjtën kohë do shërbejnë si bazë për përfaqësim argumentues ndaj vendimmarrësve, institucioneve të qeverisë lokale dhe qendrore si dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Partnerët e projektit

Projekti “Asociacioni i komunave serbe dhe marrëveshja për lirinë e lëvizjes nga këndvështrimi i komunitetit serb në Kosovë” zbatohet nga OJQ Aktiv nga Mitrovica e Veriut dhe OJQ Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik (FDMC) nga Graçanica. Produktet e projektit janë dy propozime praktike të politikave: OJQ Aktiv punën e saj e ka përqëndruar në hartimin e një propozimi për politikë praktike për lirinë

e lëvizjes në Kosovë, ndërsa OJQ Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik ka punuar në një dokument që ka të bëjë me Asociacionin e Komunave Serbe.

Ky projekt zbatohet në kuadër të platformës OPEN, të udhëhequr nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).

Rreth raportit

Raporti “Liria e lëvizjes në Kosovë dhe marrëveshjet e Brukselit nga këndvështrimi i komunitetit serb” është rezultat i hulumtimit të realizuar nga OJQ Aktiv në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile në kuadër të platformës OPEN në nëntor të vitit 2021 në mjediset në Kosovë ku serbët përfaqësojnë popullatën shumicë. Hulumtimi është realizuar me qëllim të përcaktimit të qëndrimeve, perceptimeve dhe interesave autentike të komunitetit serb në lidhje me lirinë e lëvizjes dhe marrëveshjet për lirinë e lëvizjes të arritura ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës në kuadër të dialogut të zhvilluar nën

patronazhin e të dërguarit special të Bashkimit Evropian në Bruksel. Krahas informacioneve relevante të fundit mbi Marrëveshjet e Brukselit për lirinë e lëvizjes dhe ndikimin e tyre në jetën e komunitetit serb, raporti gjithashtu shqyrton pjesërisht historikun e së drejtës për lirinë e lëvizjes së serbëve në Kosovë nga këndvështrimi i komunitetit serb. Raporti faktorëve relevant dhe organizatave të shoqërisë civile ju ofron rekomandime të caktuara që mund të shërbejnë si bazë solide për hartimin e iniciativave specifike në mënyrë që të tejkalohen sfidat dhe pengesat e perceptuara rreth çështjes së lirisë së lëvizjes.

1. Përmbledhje ekzekutive

Liria e lëvizjes është e drejtë themelore e njeriut e cila nënkupton mundësinë dhe të drejtën e një individi dhe/ose grupi për të udhëtuar lirshëm nga një vend në tjetrin brenda një ose më shumë shteteve. Në situata të caktuara, kjo e drejtë e njeriut mund të kufizohet për shkak të disa interesave të përgjithshme, si për shembull për shkak të pandemisë dhe mbrojtjes së shëndetit publik, ruajtjes së rendit, sigurisë etj. Kur është fjala për lirinë e lëvizjes së serbëve në Kosovë, për shumë vite kjo çështje ka pushtuar vëmendjen e opinionit vendor dhe ndërkom-bëtar. E parë nga këndvështrimi i komunitetit serb, çështja e lirisë së lëvizjes kryesisht u soll në kontekstin e marrëdhënieve kronike serbo-shqiptare në Kosovë, gjë që për pasojë pati kufizimin apo edhe mohimin e së drejtës së lëvizjes së lirë të serbëve. Derisa njëra palë fajësoi tjetrën, tjetra pretendonte pikërisht të kundërtën. Në mesin e vitit 2022, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, aludoi për vendosjen e reciprocitetit me Serbinë. Për këtë arsye, serbët, e veçanërisht ata në veri të Kosovës, çështjen e lirisë së lëvizjes e vendosën në kontekstin e heqjes së targave serbe për qytetet e Kosovës (PR-Prishtinë, PZ-Prizren, PE-Pejë, ĐA-Gjakovë, GL-Gjilan, KM-Mitrovicë dhe UR-Ferizaj) të lëshuara nga Serbia dhe të përdorura në veri të Kosovës në katër komuna me shumicë serbe.¹ Rezultatet e hulumtimit tregojnë për faktin se njerëzit e zakonshëm nuk dinë shumë për dialogun e Brukselit.² Për shkak

të gjithë kësaj, në këtë dokument është shumë e dobishme të prezantohen pikëpamjet e serbëve për çështjen e lirisë së lëvizjes, të cilat tregojnë një dimension autentik dhe të veçantë, por edhe kompleksitetin e kësaj çështjeje, duke lënë anash faktin se shqiptarët nga Kosova në lidhje me të gjitha këto përgjithësisht kanë mendime dhe qëndrime krejtësisht të kundërta. Pikërisht kjo shpie në nevojën që çështja e lirisë së lëvizjes në Kosovë të mos shikohet e ndarë dhe e pavarur nga ngjarjet tjera shoqërore dhe politike që kanë shënuar jetën e serbëve në Kosovë në të kaluarën e afërt apo të largët. Kjo është mënyra e vetme për të rënë dakord për zgjidhjet e çështjeve me rëndësi jetike në Kosovë, ndaj të cilave njëri komunitet shpreh rezistencë, ndërsa tjetri, shumicë, i konsideron plotësisht legjitime. Është gjithashtu e rëndësishme të informohemi për dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, i cili që nga marsi 2011 është mbajtur nën patronazhin e BE-së në Bruksel për çështje teknike si bashkëpunimi rajonal, liria e lëvizjes dhe sundimi i ligjit (aspekti teknik). Informimi dhe njohja e Marrëveshjes për parimet e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës është po ashtu mjaftë e rëndësishme, e cila marrëveshje u arrit më 19 prill 2013 (aspekti politik) dhe u zbatua vetëm pjesërisht, prandaj njëra palë në dialogu ndihet e mashtruar. Rezultatet e hulumtimit që do të diskutohet në këtë dokument, megjithatë, tregojnë se informimi i komunitetit serb rreth gjithë kësaj është në nivel jashtëzakonisht të ulët.

1 Zubin Potok, Mitrovicë e Veriut, Zvečan dhe Leposaviq.

2 Igor Marković i Boban Simić, Kosovski Srbi u procesu dijaloga, NGO AKTIV i FDMC, KFOS, 2021, mund të gjendet në: <http://ngoaktiv.org/uploads/files/01%20-%20Analiza%20Dia->

[logu%20-%20SRB%20-%2002.pdf](#)

2. Retrospektiva historike dhe socio-politike e lirisë së lëvizjes në Kosovë nga këndvështrimi i komunitetit serb

Liria e lëvizjes nga këndvështrimi i komunitetit serb të Kosovës për një kohë të gjatë ka qenë një aspekt i rëndësishëm i jetës së përditshme. Madje, mund të thuhet se liria e lëvizjes në një moment të caktuar përcaktoi vetë mënyrën e jetesës së serbëve në Kosovë, dhe se jeta dallohej vërtet për disa specifika dhe palogjikshmëri. Për të kuptuar plotësisht këto specifika dhe palogjikshmëri, mendojmë se do të ishte e dobishme të bëjmë një krahasim midis ngjarjeve të së shkuarës së largët dhe të afërt me kohën në të cilën jetojmë. Në këtë mënyrë do të kuptojmë më lehtë çdo gjecje në dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe tensionet për çështjet e dakorduara.

Administrata e UNMIK-ut në Kosovë në tetor të vitit 1999 miratoi një rregullore për regjistrimin e përkohshëm të automjeteve private³, dhe pak më vonë (2001-2002) filloi të lëshojë

3 Shih https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/04serbian/SC1999regs/RSC1999_15.pdf dhe në anglisht https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/02english/E1999regs/RE1999_15.htm

dokumente të reja personale dhe targa KS për veturat e banorëve të Kosovës, të ndryshme nga ato që ishin në përdorim deri atëherë të lëshuara nga Republika e Serbisë. Shumica e pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë vazhduan të përdorin targat e Republikës së Serbisë për qytetet në Kosovë (PR, PZ, KM, PE, GL, UR dhe ĐA), ndërsa një numër më i vogël (në jug të lumit Ibër) me kalimin e kohës (që nga viti 2002) filloi të pranojë targa KS për veturat e tij, kryesisht për arsye sigurie.⁴ Ngjashëm, patentë shoferët e lëshuar nga Republika e Serbisë për banorët e Kosovës ishin të vlefshëm deri në fund të vitit 2002, pas së cilës të njëjtit duhej të zëvendësoheshin me patentë shoferë të rinj - të Kosovës.⁵ Raportet e institucioneve

4 "Me qëllim të rritjes së lirisë së lëvizjes së pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës të cilët janë pronarë të automjeteve të regjistruara jashtë Kosovës, përfaqësuesi im special ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ 2002/6, i cili mundëson marrjen pa pagesë të targave të Kosovës për serbët e Kosovës që posedojnë automjete. Deri më tani kanë aplikuar 1231 serbë të Kosovës", paragrafi 36 i Raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Kofi Annan, të datës 29 janar 2003.

5 Rregullorja e UNMIK-ut: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/02english/E2002regs/RE2002_14.pdf

ndërkombëtare dhe ekspertëve të të drejtave të pakicave nga ajo periudhë, por edhe shumë vite më vonë, tregojnë për një "situatë të zymtë" (Kai Eide) ku dhuna masive ndaj serbëve dhe pronës së tyre më 17 mars 2004⁶ vetëm konfirmoi faktin se e drejta e lëvizjes së lirë për serbët në Kosovë është plotësisht e kufizuar dhe mund të përmbushet vetëm nën përcjellje të KFOR-it. Megjithatë, ndërmjet viteve 2001 dhe 2010, një numër në rritje i qytetarëve të kombësisë serbe në jug të lumit Ibër pranuan targa KS (dhe nga viti 2010 edhe targa RKS, kur ato u prezantuan në publik), fillimisht kryesisht për arsye sigurie, duke i mbajtur në pronësi edhe ato të lëshuara nga Serbia për udhëtime jashtë Kosovës.⁷ Në atë kohë serbët në veri të Kosovës⁸ përdorën ekskluzivisht targa serbe apo edhe vozisnin pa targa, edhe atëherë kur në raste të rralla kishin automjete të regjistruara në sistemin kosovar. Në rrethana të tilla, targat KS për serbët në jug të lbririt rrisin sigurinë e tyre dhe mundësinë e lëvizjes së lirë, ndërsa për serbët në veri të Kosovës, ku jetojnë kryesisht serbët, nuk është kështu dhe për këtë arsye nuk pranohen, ngase për ta janë një formë e integritit në sistemin kosovar. Gjatë gjithë asaj kohe, edhe pse serbët në jug të lumit Ibër ngadalë pranojnë targat KS, ende përballen me liri të kufizuar të lëvizjes. Për shembull, në fund të vitit 2002, KFOR-i mori një vendim për të ndaluar shoqërimin e fëmijëve serbë në shkollë në Cernicë afër Gjilanit, fëmijëve të pakët që mbetën të jetonin në një ndërtesë në qendër të Prishtinës (të ashtuqua-

6 Kofi Annan, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, në Raportin e tij mbi punën e Administratës së Përkohshme të OKB-së në Kosovë, S/2004/348, të datës 30 prill 2004, me rastin e 17 marsit 2004, thekson se bëhet fjalë për një "fushatë të organizuar, të gjerë dhe të synuar" për djegjen e shtëpive dhe kishave.

7 Dallimi në mes të targave të lëshuara nga Republika e Serbisë për qytetet në Kosovë (PR, PZ, PE, DJ, GL, KM dhe UR) dhe targave të përkohshme të lëshuara nga administrata e atëherëshme e UNMIK-ut ishte se targat serbe njiheshin ndërkombëtarisht, kurse targat e përkohshme KS për një kohë kanë qenë të vlefshme vetëm në Kosovë. Sot dallimi është se targat RKS nuk janë në regjimin e kartonit të gjelbër, për këtë arsye gjatë hyrjes në vendet e BE-së tarifohet policia e sigurimit, ndërsa për targat e lëshuara nga Republika e Serbisë nuk është e nevojshme. Për shembull, për të hyrë në Greqi me një automjet me targa RKS, duhet të blini një policë sigurimi që vlen 30 ditë dhe kushton 70 euro, ndërsa e gjithë kjo për shembull, për targa KM nuk është e nevojshme.

8 Zubin Potok, Mitrovicë e Veriut, Zvečan dhe Leposaviq



Shumica e pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë vazhduan të përdorin targat e Republikës së Serbisë për qytetet në Kosovë (PR, PZ, KM, PE, GL, UR dhe ĐA), ndërsa një numër më i vogël (në jug të lumit Ibër) me kalimin e kohës (që nga viti 2002) filloi të pranojë targa KS për veturat e tij, kryesisht për arsye sigurie

jtur ndërtesa e YU programit) dhe për shkak të kësaj, për katër javët e ardhshme nxënësit e nacionalitetit serb nuk kanë shkuar në shkollë.⁹ Në janar të vitit 2009, serbët nga Graçanica dhe fshatrat përreth kërkuan dhe morën përcjellje nga Shërbimi Policor i Kosovës dhe KFOR-i gjatë prerjes së organizuar të pemëve të Krishtlindjeve jashtë fshatrave të tyre.¹⁰ UNMIK-u gjatë vitit 2005, ua transferoi autoriteteve të Kosovës përgjegjësinë për regjistrimin e qytetarëve dhe lëshimin e dokumenteve, duke përfshirë patentë shoferin.

Gjatë vitit 2008 vjen deri te themelimi i Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), i cili synon të ofrojë mbështetje për institucionet përkatëse të sundimit të ligjit në Kosovë në rrugën e tyre drejt efikasitetit, qëndrueshmërisë, multietnicitetit dhe llogaridhënies më të madhe pa ndërhyrje politike dhe në harmoni të plotë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe praktikën më të mira evropiane. Në kuadër të mandatit të tij, Misioni kryen aktivitete monitoruese dhe ka kompetenca të kufizuara ekzekutive. Trendi i përdorimit të targave KS në komunitetin serb ka vazhduar

9 https://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2002&mm=10&dd=2&nav_category=11&nav_id=71800&start=-9

10 <https://www.blic.rs/vesti/drustvo/srbima-za-secu-badnja-ka-obebedena-pratnja-kfora-i-kps/nlfg8aq>

të rritet, mirëpo në jug të lumit Ibër. Në katër komuna në veri të Kosovës, numri i automjeteve të regjistruara me targa KS ishte ende simbolik dhe i papërfillshëm. Madje, edhe në rastin kur automjeti ka qenë i regjistruar me targa KS, ato targa nuk janë shfaqur dukshëm në veturat në asnjërin nga katër komunat në veri të Kosovës (është vozitur ose me targa serbe ose pa targa). Një nga arsytet e mundshme pse targat KS të prezantuara nga administrata e UNMIK-ut në vitin 2000 (në atë kohë me qëllim të "mundësimit të lirisë së lëvizjes së serbëve të Kosovës") nuk u pranuan nga serbët në veri të Kosovës, është se ato u perceptuan në kuptimin e një identiteti të veçantë të Kosovës në raport me Serbinë. Ata që i pranuan (përkatësisht serbët në jug të Kosovës) e bënë këtë për të mos u dalluar nga shumica dhe për të shmangur sulmet e shpesh-ta gjatë udhëtimit dhe për të ushtruar kështu të drejtën e lëvizjes së lirë. Në vitin 2010, Qeveria e Kosovës prezantoi targat RKS me një pamje tjetër.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se e drejta e lirisë së lëvizjes për pronarët e automjeteve me targa KS iu mohua në Serbi. Serbia me kalimin e kohës lejoi hyrjen e automjeteve me targa KS, por vetëm me targa të përkohshme serbe. Marrëveshja teknike për lirinë e lëvizjes është nënshkruar më 2 korrik 2011, zbatimi i së cilës ka filluar në vitin 2012, kur në Serbi është mundësuar qarkullimi i papenguar i automjeteve me targa KS, të cilin Kosova e anuloi duke futur targa të reja RKS, targa të cilat Srbija nuk i njeh.



Në katër komuna në veri të Kosovës, numri i automjeteve të regjistruara me targa KS ishte ende simbolik dhe i papërfillshëm. Madje, edhe në rastin kur automjeti ka qenë i regjistruar me targa KS, ato targa nuk janë shfaqur dukshëm në veturat në asnjërin nga katër komunat në veri të Kosovës (është vozitur ose me targa serbe ose pa targa). Një nga arsytet e mundshme pse targat KS të prezantuara nga administrata e UNMIK-ut në vitin 2000 (në atë kohë me qëllim të "mundësimit të lirisë së lëvizjes së serbëve të Kosovës") nuk u pranuan nga serbët në veri të Kosovës, është se ato u perceptuan në kuptimin e një identiteti të veçantë të Kosovës në raport me Serbinë.

3. Liria e lëvizjes në kuadër të dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës

Në mars të vitit 2011, nën patronazhin e BE-së në Bruksel, autoritetet në Prishtinë dhe autoritetet në Beograd filluan një dialog për çështje teknike me qëllim të zgjidhjes së problemeve praktike të qytetarëve, (nga këndvështrimi i komunitetit serb) pa shqyrtuar çështjet e statusit. Përfaqësuesit e autoriteteve në Prishtinë dhe Beograd u pajtuan se dialogu do të zhvillohet për bashkëpunimin rajonal, lirinë e lëvizjes dhe sundimin e ligjit.¹¹

Në periudhën nga viti 2011 deri në prill 2013, janë arritur shtatë marrëveshje teknike lidhur me çështjet e mëposhtme: (1) të dhënat kadastrale, (2) regjistrat civil, (3) liria e lëvizjes, (4) vula doganore, (5) njohja e diplomave universitare, (6) menaxhimi i integruar i kufijëve dhe (7) përfaqësimi rajonal dhe bashkëpunimi. Ndër këto marrëveshje është veçanërisht e rëndësishme marrëveshja për lirinë e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave, e cila mbështetet nga marrëveshja për menaxhimin e integruar të kufirit, regjistrimin dhe mbledhjen e detyrimeve doganore dhe TVSH-së, si dhe vulën doganore. Si rezultat, u themelua Fondi i Përkohshëm për Zhvillimin Ekonomik dhe Infrastrukturor të Veriut

¹¹ Shtojca 1 përmban informacion mbi çështjet teknike të diskutuara gjatë shtatë raundeve të bisedimeve të grupit të ekspertëve në Bruksel në 2011.

të Kosovës. Fondi deri më sot (2022) ende nuk është funksional. Për çdo rast, në korrik 2011, në kuadër të dialogut teknik, u nënshkrua Marrëveshja Teknike për Lirinë e Lëvizjes, e cila do të zbatohet nga nëntori i të njëjtit vit.¹² Kjo marrëveshje synonte të zvogëlonte vështirësitë në lidhje me lirinë e lëvizjes duke u mundësuar qytetarëve të Kosovës dhe qytetarëve të Serbisë të lëvizin lirshëm brenda territoreve të Kosovës dhe Serbisë me letërnjoftime (pa pasaportë). Prandaj, në praktikë është mundësuar të ushtrohet e drejta e lëvizjes së lirë për të gjithë njerëzit, pavarësisht nga lloji i dokumenteve që zotërojnë, pa procedura të veçanta administrative që do të kishin të bënin me çështjet e statusit. Në këtë pikë është me rëndësi të theksohet se, nga viti 2008 e deri në arritjen e kësaj marrëveshjeje, qytetarët e Kosovës të cilët nuk kishin dokumente serbe apo dokumente të lëshuara nga administrata e përkohshme e UNMIK-ut nuk u lejuan të udhëtojnë nëpër Serbi dhe që nga viti 2010 atë e drejtë nuk e kanë pasur as automjetet me targa RKS. Serbia njeh vetëm targa KS (të cilat ruajnë statusin neutral), por jo RKS (që përfaqësojnë Republikën e Kosovës). Hyrja në Serbi nuk

¹² Shtojca 2 është Marrëveshja Teknike për Lirinë e Lëvizjes nga viti 2011.

iu është pamundësuar targave RKS, mirëpo pronarët e këtyre automjeteve kanë marrë targa të përkohshme serbe kur udhëtonin për në Serbi. Marrëveshja ka dhënë një kontribut të madh sa i përket të drejtës së lirisë së lëvizjes, sepse numri mesatar i personave që udhëtojnë nga Kosova në Serbi, në baza vjetore ka arritur shifrën prej 144,319 personash, prej të cilëve 4,811 janë në baza ditore. Sa i përket kalimeve nga Serbia në Kosovë, në këtë drejtim kanë udhëtuar në baza vjetore 142.209 persona, d.m.th. 4,740 në baza ditore.¹³ Ky ishte një tregues i qartë se marrëveshja pas fillimit të zbatimit i shërbeu qëllimit të saj marrë parasysh rritjen e fluksit të njerëzve dhe mallrave.

Me datë 19 prill 2013, të dy palët, përmes BE-së, nënshkruan Marrëveshjen e Brukselit,¹⁴ e cila po që se do të ishte zbatuar plotësisht në praktikë do të mund të mbante epitelin e "marrëveshjes historike". Përkatësisht, sipas pikëpamjeve të përfaqësuesve të atëhershëm të autoriteteve serbe dhe kosovare, kjo marrëveshje është dashur të zvogëlojë potencialin për konflikte të ardhshme në Ballkanin Perëndimor dhe të largojë një nga pengesat e fundit për Serbinë dhe Kosovën në rrugën drejt anëtarësimit në BE. Si një nga problemet kryesore që u shfaq për pjesëtarët e komunitetit serb në veri të Kosovës nga Marrëveshja e Brukselit, është se ajo krijoi hapësirë për integrimin e katër komunave në sistemin juridik të Kosovës. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Brukselit nga Beogradi zyrtar sinjalizoi tërheqjen e disa institucioneve serbe, organizimin e zgjedhjeve të Kosovës dhe themelimin e institucioneve të Kosovës në veri të Kosovës, ku që nga viti 1999 këto institucione funksiononin në kuadër të sistemit serb (vetëqeverisja lokale, gjyqësori, mbrojtja civile, arsimit, edukimi, kujdesi shëndetësor, etj.).

¹³ Burimi: https://www.centarzaregionalizam.org.rs/prilozi/monitoring/Monitoring_SRB.pdf

¹⁴ Shtojca 3 përmban Marrëveshjen e Brukselit (Marrëveshja e Parë mbi parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve).

2011

Për çdo rast, në korrik 2011, në kuadër të dialogut teknik, u nënshkrua Marrëveshja Teknike për Lirinë e Lëvizjes, e cila do të zbatohet nga nëntori i të njëjtit vit. Kjo marrëveshje synonte të zvogëlonte vështirësitë në lidhje me lirinë e lëvizjes duke u mundësuar qytetarëve të Kosovës dhe qytetarëve të Serbisë të lëvizin lirshëm brenda territoreve të Kosovës dhe Serbisë me letërnjoftime (pa pasaportë)

Në shtator të vitit 2016, Beogradi dhe Prishtina¹⁵ ranë dakord për përdorimin e afisheve (stikerëve) mbi targat RKS gjatë udhëtimit nëpër Serbi, si dhe mbi targat serbe nëpër Kosovë. Mirëpo, kjo masë, pasi u dakordua, nuk zuri rrënjë në praktikë. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se në kuadër të dialogut teknik është arritur marrëveshje për vazhdimin e vlefshmërisë së targave KS për pesë vjetë, të cilat sipas këndvështrimit serb janë "status neutrale", d.m.th. deri në vitin 2016, e më pas vlefshmëria u vazhduar nga viti 2016 edhe për pesë vite të tjera, pra deri në vitin 2021. Megjithatë, në vitin 2020, Qeveria e Kosovës hoqi targat KS. Një vendim i tillë ka lënë një numër të madh të pronarëve të veturave me targa KS vetëm me një mundësi, e që është reregjistrimi i automjetit me targa RKS.¹⁶

Në kontekstin e së drejtës së lëvizjes së lirë të serbëve në Kosovë, duket se në këtë pikë vlen të theksohen disa shembuj të shkeljeve të marrëveshjeve të arritura (për lirinë e lëvizjes dhe të tjera) nga institucionet e Kosovës dhe Qeveria

¹⁵ Shtojca 4 përmban Marrëveshjen ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës për përdorimin e afisheve mbi targa.

¹⁶ Burimi: <http://ngoaktiv.org/srb/news/multiple-number-plates-multiple-problems>

e Kosovës e udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti. Përkatësisht, qershori i vitit 2021 u shënua me ndalime (të liriës së lëvizjes) për hyrjen e organizuar të përfaqësuesve të familjeve serbe të Kosovës (ish-banorë të Kosovës) nga Serbia në Kosovë për qëllime perkujtimore dhe vizita në varreza në Mushtisht, Suharekë, Hoçë të Madhe, Zaçishtë dhe vende të tjera.¹⁷ Autobusët me serb të Kosovës, ardhja e të cilëve ishte njoftuar në mënyrë të rregullt tek institucionet kompetente kosovare, në përputhje me praktikën e vendosur dhe marrëveshjet teknike të arritura, fillimisht janë lejuar të hyjnë në Kosovë, por janë ndaluar në gjysmë të rrugës dhe janë kthyer në Serbi nga Policia e Kosovës. Gjithashtu, u ndalua hyrja e autobusit me pelegrinët që do të vizitonin manastiret ortodokse në Kosovë. Në mënyrë të ngjashme, hyrja e një grupi të organizuar të alpinistëve nga Serbia dhe rajoni u ndalua për ecjen tradicionale në malin Sharr në prag të festës serbe të Vidovdanit (28 qershor).¹⁸ Madje një numër i caktuar autobusësh me grupe alpinistësh kanë hyrë pa pengesa në Kosovë, mirëpo janë kapur dhe kthyer nga Policia e Kosovës me shpjegime të prera dhe të palogjikshme. Ngjashëm, grupet e alpinistëve të cilët në anën tjetër kanë arritur disa ditë më parë në destinacionet e dëshiruara në Brezovicë, në Komunën e Shtërpçës, nga Policia e Kosovës janë njoftuar se nuk mund të dalin për alpinizëm për arsye sigurie.

Në shtator të vitit 2021, kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Albin Kurti, merr vendimin e paralajmëruar prej kohësh për zbatimin e parimit të "reciprocitetit", me të cilin vendim ndalohet udhëtimi i automjeteve me targa serbe në Kosovë dhe me çka paralajmërohet konfiskimi i veturave me targa të lëshuara nga Republika e Serbisë për qytetet e Kosovës (PR, PZ, PE, ĐA, KM, GL dhe UR). Qeveria e Kosovës për zbatimin e këtij vendimi në veri të Kosovës dërgoi forca speciale policore me automjete të blinduara. Serbët në

17 <https://kossev.info/kancelarija-za-kim-autobus-sa-50-vernika-iz-centralne-srbije-pusten-pa-vracen-sa-km/>

18 <https://www.danas.rs/vesti/drustvo/kancelarija-za-kosovo-i-metohiju-zabrana-kretanja-planinarima-je-sovinizam/>

2016

Në shtator të vitit 2016, Beogradi dhe Prishtina ranë dakord për përdorimin e afisheve (stikerëve) mbi targat RKS gjatë udhëtimit nëpër Serbi, si dhe mbi targat serbe nëpër Kosovë. Mirëpo, kjo masë, pasi u dakordua, nuk zuri rrënjë në praktikë. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se në kuadër të dialogut teknik është arritur marrëveshje për vazhdimin e vlefshmërisë së targave KS për pesë vjetë, të cilat sipas këndvështrimit serb janë "status neutrale", d.m.th. deri në vitin 2016, e më pas vlefshmëria u vazdhua nga viti 2016 edhe për pesë vite të tjera, pra deri në vitin 2021.

veri të Kosovës të pakënaqur me vendimin dhe vendosjen e mjeteve të blinduara të forcave speciale të policisë kanë bllokuar rrugët (me kamionë, vetura dhe trupa të tyre) që çojnë në dy vendkalime me Serbinë - Jarinjë dhe Bërnjak. Përfundimi i bllokadës u kushtëzua me anulimin e këtij vendimi. Pas 12 ditësh bllokadash dhe tensione, me ndërmjetësimin e përfaqësuesve të BE-së, u arrit kompromisi dhe tërheqja e forcave speciale policore nga Jarinja dhe Bërnjaku, vendosja e përkohshme e pjesëtarëve të KFOR-it dhe largimi i njëkohshëm i bllokadave të rrugëve nga serbët e Kosovës.¹⁹ Kështu u vendos i ashtuquajtur regjimi i afisheve apo stikerëve (nga viti 2016) me mbulim të detyrueshëm të pjesëve të targave, si masë e përkohshme para marrëveshjes përfundimtare të targave që duhet të arrihet në vitin 2022. Prandaj, për këtë qëllim

19 <https://www.slobodnaevropa.org/a/kosovo-blokada-jarinje-brnjak-srbija/31486039.html>

u formua Grupi Punues, i cili brenda gjashtë muajve do duhej të arrinte një marrëveshje përfundimtare për çështjen e lirisë së lëvizjes dhe targave. Përdorimi i serishëm i "stikerëve" është i kufizuar në gjashtë muaj,²⁰ deri në arritjen e një zgjidhje afatgjate dhe të qëndrueshme nga ekipet e Beogradit dhe Prishtinës.

Ai afat skadoi në prill të vitit 2022, dhe delegacionet negociuese nuk u dakorduan se si duhet të duket zgjidhja përfundimtare në lidhje me lirinë e lëvizjes dhe targat. Prandaj, Qeveria e Kosovës ka vendosur serish që rregullat e reja t'i zbatojë vetë. Përkatësisht, në korrik të vitit 2022, me vendim të Qeverisë së Kosovës u dha mundësia që më 1 gusht të fillojë periudha e reregjistrimit të automjeteve me targa serbe të qyteteve të Kosovës në targa RKS. Për qytetarët që dëshirojnë ta bëjnë këtë, ofrohen përfitime, si përjashtimi nga detyrimet doganore për automjetet që tashmë janë zhdoganuar në Serbi. Në të njëjtën kohë, ata që nuk i reregjistrojnë automjetet pas përfundimit të afatit dy mujor kërcënohen me "konfiskim". Vendimi i Qeverisë së Kosovës parashihte edhe masën e reciprocitetit ndaj Serbisë në formë të lëshimit të të ashtuquajturave dokumentave për "hyrje-dalje", siç thuhet në marrëveshjen e vitit 2011, apo "letër deklarate", siç e quan Qeveria e Kosovës të gjithë shtetasve që paraqiten në vendkalimet me Kosovën me letërnjoftime të Serbisë. Të pakënaqur me vendimin, serbët në veri të Kosovës serish i kanë bllokuar rrugët me barrikada dhe kategorikisht kanë refuzuar ta zbatojnë vendimin. Me ndërmjetësimin e BE-së dhe Ambasadës Amerikane në Prishtinë, është shmangur përshkallëzimi i mëtejshëm me faktin se Qeveria e Kosovës ka pranuar rekomandimet e BE-së dhe Ambasadës Amerikane për shtyrjen e zbatimit të vendimit për një muaj, d.m.th. deri më 1 shtator 2022.²¹

²⁰ https://www.eeas.europa.eu/eeas/belgrade-pristina-dialogue-chief-negotiators-reach-arrangement-resolve-tension-north-kosovo_en?fbclid=IwAR0YHDomatFVUoOfFP-G8n30KxlwyX6GyonXZIDlY_bInnKF94tDKBegMIIM

²¹ <https://www.danas.rs/vesti/politika/kurti-odlozio-pri-menu-reciprociteta-za-30-dana/>

2022

Qeveria e Kosovës ka vendosur serish që rregullat e reja t'i zbatojë vetë. Përkatësisht, në korrik të vitit 2022, me vendim të Qeverisë së Kosovës u dha mundësia që më 1 gusht të fillojë periudha e reregjistrimit të automjeteve me targa serbe të qyteteve të Kosovës në targa RKS. Për qytetarët që dëshirojnë ta bëjnë këtë, ofrohen përfitime, si përjashtimi nga detyrimet doganore për automjetet që tashmë janë zhdoganuar në Serbi.

Se si ky varg ngjarjesh ka ndikuar në jetën e përditshme të njerëzve në Kosovë, sa janë në dijeni për Marrëveshjen për lirinë e lëvizjes dhe zbatimin e saj, cilat janë pritjet dhe dyshimet e tyre, janë çështjet të trajtuara nga organizatat e shoqërisë civile në kuadër të platformës OPEN. Me qëllim të një pasqyre më të plotë të opinionit publik për lirinë e lëvizjes dhe me rastin e miratimit të masave të reja të reciprocitetit të Kosovës ndaj Serbisë në pjesën e Marrëveshjes së Brukselit nga viti 2011 që i referohet targave të veturave për pasagjerë dhe bartjen e mallrave, ata në partneritet realizuan hulumtimin në zonat me shumicë serbe në Kosovë.

Organizatrat e shoqërisë civile në kuadër të platformës OPEN me hulumtimin e realizuar do të kërkojnë të ofrojnë mbështetje për qytetarët përmes avokimit të mëtejshëm për një zgjidhje të qëndrueshme e të pranueshme nga të dyja palët, ku qytetarët e prekur nga liria e lëvizjes janë pjesëmarrës aktivë dhe mendimi i të cilëve gjatë bisedimeve dhe vendimmarrjes duhet të merret parasysh.

4. Hulumtimi mbi temën e lirisë së lëvizjes

Metodologjia

Për qëllime të këtij dokumenti, është realizuar një hulumtim i detajuar në terren. Hulumtimi është kryer në zonat me shumicë serbe në Kosovë, në një mostër prej 600 të anketuarve të stratifikuar sipas vendbanimit (300 në veri dhe në jug të lumit Ibër), gjinisë dhe moshës. Është marrë parasysh përfaqësimi i të anketuarve sipas komunave, si dhe përfaqësimi i barabartë i të anketuarve të të dy gjinive në secilën komunë. Qasja metodologjike për mbledhjen e të dhënave është hartuar në formën e pyetësorëve, intervistave ballë për ballë dhe fokus grupeve. Grupi i pyetjeve u formulua në bazë të hulumtimit paraprak analitik. Në këtë raport, të dhënat do të paraqiten kryesisht përmes variablave individuale, të cilat janë relevante nga aspekti i qëllimit të hulumtimit. Të dhënat e fituara nga fokus grupet dhe intervistat janë grupuar sipas fushave dhe paraqitur tërësisht ose pjesërisht sipas relevancës dhe rëndësisë së informacionit të marrë.

Analiza e gjetjeve të hulumtimit

Gjetjet e mbledhura gjatë hulumtimit dhanë bazën për analizën e nivelit të informimit për lirinë e lëvizjes, Marrëveshjen e Brukselit, ndikimin e vendimmarrjes në cilësinë e jetës. Gjithashtu, një nga qëllimet e hulumtimit ishte vlerësimi i sigurisë së qytetarëve gjatë gëzimit të së drejtës së lëvizjes së lirë, veçanërisht në mesin e atyre që përdorin dokumente personale të lëshuara në Kosovë dhe Serbi, dhe që përdorin targa me statuse të ndryshme juridike (varësisht se cila palë i vëzhgon/interpreton dhe në çfarë mënyre i zbatojnë marrëveshjet e dakorduara).

Me qëllim të një kuptimi më gjithëpërfshirës, në analizën e gjendjes së lirisë së lëvizjes janë marrë parasysh edhe pikëpamjet e individëve/ekspertëve që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë janë pjesë e këtij procesi. Pikëpamjet e individëve të intervistuar kryesisht përkrijnë në natyrën e tyre pesimiste, ngase ata besojnë se nuk ka vullnet politik për zgjidhjen e këtij problemi dhe se ngjarje të tilla si zgjedhjet në shumicën e rasteve ndikojnë në vetë rrjedhën e bisedimeve dhe zbatimin (e marrëveshjeve të dakorduara). Gjithashtu, përgjigjet tregojnë për faktin se situata e paqëndrueshme politike çon në një situatë të brishtë të sigurisë, e cila ndër të tjera ndikon në lirinë e lëvizjes, pra rrit rrezikun gjatë lëvizjes me simbole apo shenja të shtetësisë, në këtë rast targa.

Grafiku 1. A jeni në dijeni të dispozitave të Marrëveshjes për lirinë e lëvizjes, të nënshkruar në vitin 2011 dhe të rinovuar në vitin 2016 nga ekipet negociatore të Beogradit dhe Prishtinës?



Kur bëhet fjalë për ndërgjegjësimin e qytetarëve për Marrëveshjen për lirinë e lëvizjes, hulumtimi ka treguar se 39.8% e të anketuarve nuk janë në dijeni të dispozitave të saj, dhe se një numër i ngjashëm i të anketuarve (38.8%) janë pjesërisht në dijeni. Nga ana tjetër, 15.4% nuk kanë asnjë informacion në lidhje me këtë marrëveshje, gjë që mund të interpretohet si pasojë e mungesës së komunikimit të drejtpërdrejtë ndërmjet akterëve politikë (pra, institucioneve) dhe qytetarëve. Gjithashtu, anketa tregon se një numër i vogël i qytetarëve (6% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve) janë plotësisht në dijeni të kësaj marrëveshjeje.


Nga përgjigjet e mësipërme, mund të konstatohet se një nga problemet kyçe është mungesa e njohurisë së qytetarëve rreth përmbajtjes së vetë marrëveshjes. Ka një dallim të konsiderueshëm në qëndrimet e qytetarëve që jetojnë në veri dhe në jug të lumit Ibër, që i referohet

përgjigjeve "pjesërisht" dhe "nuk jam fare i njohuar", ku në veri numri i atyre që nuk kanë fare njohuri rreth marrëveshjes është dukshëm më i madh (45% e të anketuarve). Një përqindje dukshëm më e lartë e atyre që kanë pjesërisht dijeni rreth marrëveshjes në jug mund të arsyetohen me faktin se institucionet, përfshirë edhe Policinë e Kosovës, janë shumë më rigorozë në zbatimin e rregullave në jug sesa në veri. Kur bëhet fjalë për regjimin e "stikerit", anketa tregon se pothuajse gjysma e të anketuarve (49.2%) posedojnë vetura me targa serbe të qyteteve në Kosovë dhe targa me qytete në Serbi, gjë që tregon numrin e veturave që udhëtojnë me stiker të ngjitur në territorin e Kosovës, veçanërisht në veri të Kosovës. Ky është një informacion i rëndësishëm, sepse pjesëmarrësit e fokus grupeve që jetojnë në veri të lumit Ibër kanë pasur qëndrime veçanërisht kritike ndaj zgjidhjes së përkohshme me "stiker", që sipas tyre e vështirësoi lëvizjen e tyre dhe

krijoi tensione.²² Gjithashtu, u tha se ai përfaqëson një disfatë politike²³, ngase pjesëmarrësit besojnë se është bërë një kompromis ndaj vendimeve të njëanshme të qeverisë së Kosovë. Gjithashtu, në intervistat e realizuara në kuadër të hulumtimit, në pyetjen "A është një zgjidhje e mirë vendosja e stikerëve?", një nga përgjigjet ishte se stikerët nuk përfaqësojnë një zgjidhje të mirë dhe afatgjatë.²⁴ Mirëpo, për pronarët e targave RKS, kjo zgjidhje paraqet lehtësim

në aspektin procedural dhe financiar, sepse stikerët edhe pse një zgjidhje e përkohshme, ulën shpenzimet për pronarët e këtyre veturave, të cilët paraprakisht gjatë hyrjes në Serbi ishin të detyruar të pajiseshin me targa provuese. Mirëpo, numri i veturave me targa RKS në veri të Kosovës është dukshëm më i ulët, ndërsa ky vendim për qytetarët dhe pronarët e veturave me targa të qytetit sipas sistemit të Republikës së Serbisë, nuk ishte shumë i dobishëm.

Grafiku 2. Përshkrimi krahasues i përgjigjeve të të anketuarve në jug dhe veri



22 Raport nga fokus grupi në Leposaviq.

23 Raport nga fokus grupet në Mitrovicën e Veriut dhe Zubin Potok.

24 Intervistë me Darko Dimitrijeviqin dhe Nenad Radosavleviqin.

Grafiku 2 tregon dallimin e jashtëzakonshëm në pronësinë e veturave me targa RKS (jug 58.6% - Veri 0.6%). Ky fakt vërteton të dhënat paraprake për përqindjen e veturave në trafik në territorin e Kosovës që përdorin stiker dhe të cilëve i referohet vendimi i përkohshëm për përdorimin e tyre. Po ashtu, një fakt i rëndësishëm është se 47.50% e veturave në trafik janë ato me targa serbe të qyteteve në Kosovë. Ky informacion është i rëndësishëm në kuptimin se statusi i tyre ligjor në veri të Kosovës ende "tolerohet" nga Policia e Kosovës. Megjithatë, ajo që do të ndikojë shumë në lirinë e lëvizjes së qytetarëve është informacioni që është theksuar shpesh nga të intervistuarit, se të gjithë ata që kanë targa KM, PR, GL, UR, PZ, PE, ĐA nuk do të mund të vazhdojnë regjistrimin, por do të kenë lehtësira gjatë regjistrimit të veturave të tyre me targa RKS²⁵. Kur bëhet fjalë për targat RKS dhe KS, analiza e përgjigjeve të ofruara nga pjesëmarrësit e fokus grupeve nga Graçanica, Anamorava dhe Shtërpca, të cilët në numër më të madh i posedojnë këto targa, tregon se shumica e tyre gjatë përdorimit të targave në fjalë nuk kanë pasur ndonjë problem në Serbi, megjithëse ka pasur një numër të vogël incidentesh, përjashtime nga trafiku nga policia apo dëmtime në parking. Mirëpo, kur bëhet fjalë për targat e qyteteve në Serbi, pjesëmarrësit, sipas dëshmisë së tyre, kanë përjetuar një lloj diskriminimi apo shqetësimi, si përjashtimi i qëllimshëm nga trafiku, tejkalimi i autorizimeve nga policia e Kosovës, gjuajtja me gurë në rrugë ose në parking. Një nga shembujt nga fokus grupi ku qytetarët folën për cenimin e lirisë së lëvizjes ishte se policia e Kosovës nuk e njohu njërin nga dokumentet e bashkëbiseduesit për shkak se dokumenti ishte i shkruar në cirilik dhe i lëshuar nga Republika e Serbisë.²⁶ Përveç kësaj, pjesëmarrësit e hulumtimit theksuan se, megjithëse duhen pesë deri në dhjetë minuta për të lëshuar targat provuese, pritja në vendkalimin Jarinjë ishte shumë më e gjatë dhe se aspekti financiar ishte i rëndë që me përdorimin e stikerëve pa pagesë tani më është eliminuar.

25 Intervistë me Nenad Radosavleviqin.

26 Raporti nga fokus grupi në Graçanicë.



Kur bëhet fjalë për targat RKS dhe KS, analiza e përgjigjeve të ofruara nga pjesëmarrësit e fokus grupeve nga Graçanica, Anamorava dhe Shtërpca, të cilët në numër më të madh i posedojnë këto targa, tregon se shumica e tyre gjatë përdorimit të targave në fjalë nuk kanë pasur ndonjë problem në Serbi, megjithëse ka pasur një numër të vogël incidentesh, përjashtime nga trafiku nga policia apo dëmtime në parking.

Krijohet përshtypja se pronarëve të automjeteve me targa RKS ju konvenon regjimi i stikerëve, sepse procedura është më e shkurtër dhe pa kompensim monetar.

Kur bëhet fjalë për kalimin e vendkalimeve administrative, pyetjes "A keni pasur ndonjëherë probleme në një nga vendkalimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (Jarinjë, Bërnjak, Merdare, Dheu i Bardhë, etj.)" pozitivisht janë përgjigjur 6% e të anketuarve, ndërsa 12 % nuk ishin të sigurt ose nuk ju kujtohet (Grafiku 3). Ndër problemet me të cilat janë ballafaquar të anketuarit në pyetësor ka qenë i përfshirë problemi me targat, stikerët – letrat ngjitëse, kërkimin e autorizimeve të ndryshme dhe "shqetësime". Është e nevojshme të organizohet një fushatë publike për ndërgjegjësimin e qytetarëve për mekanizmat në dispozicion për parandalim dhe mbrojtje në rastet si ato të përshkruara, të cilat do të parandalonin çdo formë të diskriminimit për këtë çështje, ndërsa në këto raste Inspektorati i Policisë së Kosovës²⁷ është institucioni primarë kompetent për parashtrimin e ankesave ndaj punës së Policisë së Kosovës.

27 <https://ipk.rks-gov.net/?lang=sr>.

Grafiku 3. Problemet me të cilat ballafaqohen të anketuarit në vendkalime



Pjesëmarrësit e fokus grupeve në katër komunat veriore e kanë ndërlidhur lirinë e lëvizjes me çështjen e sigurisë së përgjithshme në atë pjesë të Kosovës. Konfuzion dhe komplikim shtesë për banorët e katër komunave në veri të Kosovës krijon dokumentacioni, konkretisht letërnjoftimet e lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë për qytetarët që banojnë në një nga qytetet e territorit të Kosovës. Është e qartë se konfuzioni është krijuar nga interpretimi i ndryshëm i asaj që u ra dakord në Bruksel, dhe siç shihet nga raporti i fokus grupit, reflekton si në lirinë e lëvizjes ashtu edhe në sigurinë e përgjithshme.²⁸

Gjithashtu, bashkëbiseduesit u pajtuan se në kompleksitetin e problemit kontribuojnë edhe çështje të tjera të pazgjidhura, si targat

e veturave, por edhe dokumentet personale, kadastrat, diplomatat e të ngjashme. Njëri nga bashkëbiseduesit pohoi gjithashtu se problemet lindin kryesisht për shkak të dokumenteve dhe mospërputhjeve të tyre. Për momentin është një numër i madh i atyre që kanë vetëm dokumente serbe me qytetet e Kosovës. Në anën tjetër, një numër i madh i njerëzve kanë probleme me marrjen e dokumenteve të Kosovës²⁹. Edhe pas 11 vitesh nga fillimi i zbatimit të vendimeve për ndërprerjen e vlefshmërisë së dokumenteve (të lëshuara nga institucionet serbe në Kosovë), ato ende përdoren nga disa qytetarë. Praktika tregon edhe një kufizim tjetër të lëvizjes, edhe kur të gjitha kushtet sipas ligjeve të Kosovës për udhëtime plotësohen, e ai është udhëtimi i organizuar i besimtarëve apo studentëve në manastiret e Kosovës. Arsyetimet e zyrtarëve të Policisë së Kosovës janë të natyrës administra-

²⁸ Raporte nga fokus grupet në Mitrovicën e Veriut dhe Zubin Potok.

²⁹ Intervistë me Darko Dimitrijeviq.

tive, ku kërkohet njoftim paraprak për udhëtime të tilla. Organizatorët shpesh mbesin të habitur nga këto procedura dhe kushte sepse nuk është një praktikë e përditshme.³⁰

Masat e qeverisë së Kosovës për parandalimin e Covid-19 kanë ndikuar edhe në lirinë e lëvizjes³¹, dhe njëri nga bashkëbiseduesit është i mendimit se Qeveria e Kosovës u nxitua me vendimin e “ashpër” për vaksinimin, si rrugë të vetme për të hyrë në Kosovë dhe mendon se nuk është për t'u habitur që shpejtë është hequr dhe janë shtuar më shumë opsione dhe mundësi për të hyrë në Kosovë, si testi PCR negativ dhe të ngjashme³². Një bashkëbisedues tjetër theksoi se “në vend që të bëjnë më shumë përpjekje për të vaksinuar popullatën, po bëjnë gjithçka për të detyruar të tjerët që hyjnë në Kosovë ta bëjnë këtë”³³.



Edhe pas 11 vitesh nga fillimi i zbatimit të vendimeve për ndërprerjen e vlefshmërisë së dokumenteve (të lëshuara nga institucionet serbe në Kosovë), ato ende përdoren nga disa qytetarë. Praktika tregon edhe një kufizim tjetër të lëvizjes, edhe kur të gjitha kushtet sipas ligjeve të Kosovës për udhëtime plotësohen, e ai është udhëtimi i organizuar i besimtarëve apo studentëve në manastiret e Kosovës.

Prandaj, bazuar në analizën e përgjigjeve të të anketuarve, arsyeja pse liria e lëvizjes është ende relevante në Kosovë qëndron në:

- ⊖ zgjatjen e zbatimit të dispozitave të dakorduara nga Marrëveshja e Brukselit,
- ⊖ plasimin në publik të interpretimeve kontraktore të marrëveshjes ndërmjet Beogradit zyrtar dhe Prishtinës zyrtare,
- ⊖ marrjen e vendimeve të njëanshme, mospjesëmarrjen e opinionit publik në gjetjen e zgjidhjeve kompromise, dhe
- ⊖ mospërfilljen e nevojave reale të qytetarëve.

Duke pasur parasysh rolin e Bashkimit Evropian në procesin e bisedimeve dhe, sipas disa pjesëmarrësve në hulumtim, sjelljen disi pasive të përfaqësuesve të tyre në Prishtinë, mungesa e konsistencës në zbatimin e çështjeve të dakorduara ndikon negativisht tek qytetarët në aspektin e besimit të tyre në Marrëveshjen në fjalë.

30 <https://www.danas.rs/vesti/drustvo/dva-autobusa-iz-srbije-vracena-jutros-sa-jarinja/>

31 <http://www.ngoaktiv.org/srb/publication/towards-a-more-equal-reponse-to-the-covid-19-pandemic-in-kosovo>

32 Intervistë me Marko Jakshiqin.

33 Intervistë me Isak Vorguçiqin.

5. Konkluzionet kyçe

- 1 Në shumicën e rasteve, qytetarët e anketuar nuk janë ose janë pjesërisht në dijeni të Marrëveshjes për lirinë e lëvizjes. Janë vërejtur dallime në përgjigjet e të anketuarve që jetojnë në veri dhe në jug të lumit Ibër sa i përket posedimit të targave të veturave (të MPB-së së Serbisë dhe MPB-së së Kosovës) kontribuon në qëndrimet e tyre të ndryshme ndaj të ashtuquajturës zgjidhjes me "stiker".
- 2 Qytetarëve në veri të Kosovës kjo zgjidhje në aspektin praktik dhe politik nuk ju pëlqen, ndërsa qytetarëve në jug të Kosovës një zgjidhje e tillë iu diktohet nga zbatimi rigoroz i një sërë dispozitash ligjore të cilat krahasuar me zgjidhjet e mëparshme kanë kosto më të ulëta për qytetarët.
- 3 Një përqindje e caktuar e qytetarëve i perceptojnë kontrollet, bastisjet dhe kërkesat për dokumente në vendkalime si shqetësime nga personat zyrtarë, duke dëshmuar për sjellje joprofionale dhe shpërdorim të detyrës së tyre.
- 4 Shqetësimet për sigurinë e përgjithshme të lëvizjes brenda territorit të Kosovës janë karakteristike e përbashkët e qytetarëve në veri dhe në jug të lumit Ibër, ku shqetësimi për pronarët e veturave me targa të qyteteve në Serbi është disi më i madh.
- 5 Qytetarët nuk janë të informuar mjaftueshëm dhe shpeshherë janë në dyshim se cilat dokumente janë të vlefshme, gjegjësisht të pranuara, qoftë nga MPB-ja e Serbisë apo nga MPB-ja e Kosovës.
- 6 Personat e zhvendosur përkohësisht përballen me vështirësi gjatë ushtrimit të së drejtës për posedim të dokumenteve personale, ndërkohë që procedura për marrjen e dokumenteve të Kosovës shpeshherë është e gjatë dhe krijon një barrë financiare shtesë për këtë kategori të qytetarëve.
- 7 Shumica e të anketuarve besojnë se zgjidhja me "stiker" është e paqëndrueshme në planin afatgjatë.

6. Rekomandime

Rekomandime për përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës

- ⊖ Arritja e një zgjidhjeje kompromisi që do të merrte parasysh nevojat dhe interesat e pjesëtarëve të komuniteteve lokale. Parakusht për këtë është komunikimi i drejtpërdrejtë me qytetarët.
- ⊖ Miratimi i një pakoje masash nga Qeveria e Kosovës, që do të mundësonte informim më të mirë të personave të zhvendosur, do të lehtësonte komunikimin me ministrinë përkatëse dhe Qendrat për Regjistrimin Civil në Kosovë, gjë që do të krijonte parakushte për përmirësimin e të drejtave të garantuara me kushtetutë dhe ligj, veçanërisht në lëshimin e dokumenteve personale të reja ose vazhdimin e tyre për personat e zhvendosur.
- ⊖ Krijimi i sistemit funksional të kontrollit të brendshëm të kodit të mirësjelljes së pjesëtarëve të MPB-së së Kosovës në vendkalimet drejt Kosovës, me qëllim të parandalimit të efekteve negative tek qytetarët e caktuar, pronarë të veturave me targa të Serbisë qendrore, e që kanë të bëjnë edhe me mosrespektimin e dispozitave ligjore sa i përket lëvizjes së lirë të qytetarëve dhe të drejtave të tyre.
- ⊖ Harmonizimi i normave gjuhësore në nivel të të gjitha institucioneve kompetente, Qeverisë së Kosovës, Policisë së Kosovës, Inspektoratit Policor me fokus në nevojat reale të qytetarëve dhe kuptim të plotë të përmbajtjes që u ofrohet pjesëtarëve të Serbisë dhe komuniteteve tjera jo shumicë.
- ⊖ Vendosija e një kanali funksional të komunikimit me qytetarët e komuniteteve joshumicë brenda Kosovës dhe personave të zhvendosur përmes një fushate njëvjeçare të informimit publik që synon ofrimin e një gamë më të gjerë të informacionit me rëndësi publike, me fokus të veçantë në regjimin e lëvizjes në Kosovë dhe Serbi, mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve (dhe të ngjashme) nga Qeveria e Kosovës, ministrinë e linjës dhe agjencitë që kanë për përgjegjësi kryesore komunikimin me qytetarë.
- ⊖ Kryetarët komunave të inkurajojnë përfaqësuesit e interesuar të shoqërisë civile të marrin pjesë në takimet e komiteteve komunale të sigurisë.³⁴

34 <https://www.kosovopolice.com/sr/policija-u-zajednici/opstinski-odbori-za-bezbednost-zajednice/>

Rekomandime për organizatat e shoqërisë civile

- ⊖ Të prezantohet Raporti për lirinë e lëvizjes nga këndvështrimi i komunitetit serb tek institucionet kosovare, organizatat e shoqërisë civile dhe të organizohen debate të hapura që do të kontribuonin në qetësimin e tensioneve dhe kuptimin e nevojave dhe interesave të “palës tjetër”.
- ⊖ Krijimi i një sistemi të vazhdueshëm komunikimi ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve përkatëse me qëllim të shkëmbimit të informacionit mbi vështirësitë dhe nevojat e qytetarëve dhe personave të zhvendosur, me synimin për të ndikuar në ndryshimin e praktikave të këqija dhe zgjidhjeve jofunksionale që prekin drejtpërdrejt një shtresë më të gjerë qytetarësh.
- ⊖ Shoqëria civile në hulumtimet e saj duhet të përfshijë një numër më të madh të qytetarëve të të gjitha moshave dhe grupeve arsimore nga zonat urbane dhe rurale.
- ⊖ Krijimi i një platforme për komunikim dhe shkëmbim të informacionit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të ekipeve negociuese në Prishtinë dhe Beograd, me qëllim të shkëmbimit të informacionit mbi procesin e dialogut, sigurimin e informacionit përkatës dhe të bazuar në fakte mbi ndikimin e marrëveshjeve specifike në rrjedhat sociale.
- ⊖ Të mundësohet një hapësirë e hapur për dialog të papenguar dhe të drejtpërdrejtë ndërmjet shoqërisë civile nga Kosova dhe Serbia për temat kyçe në procesin e bisedimeve, me fokus të veçantë në procesin e dekonstruktimit të retorikës negative të përfaqësuesve kryesorë politikë nga Beogradi dhe Prishtina.

Rekomandime për media

- ⊖ Të inkurajohen përfaqësuesit e mediave kyçe që në mënyrë më transparente dhe proaktive të informojnë qytetarët për marrëveshjet e arritura në procesin e bisedimeve.
- ⊖ Mediat dhe shoqëria civile duhet të kërkojnë nga ndërmjetësi i BE-së që në bisedimet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës të përdorë autoritetin e tij për të kërkuar përgjegjësi të plotë nga ekipet negociatore për procesin e bisedimeve, duke u përmbytur nga retorika nxitëse dhe interpretimi i dyfishtë i asaj që është dakorduar, duke insistuar për konferenca të përbashkëta për shtyp pas çdo raundi bisedimesh.

7. Shtojcat

SHTOJCA 1 Dialogu teknik midis Beogradit dhe Prishtinës 2011.

RAUNDI	DATA	TEMA TË DISKUTIMIT DHE MARRËVESHJET E ARRITURA
1	8 dhe 9 mars	<ul style="list-style-type: none"> - bashkëpunimi ekonomik ndërmjet dy palëve - telekomunikacioni - trafiku ajror - vulat doganore - çështjet e kadastrit dhe arkivave
2	28 mars	<ul style="list-style-type: none"> - lëvizja e lirë - furnizimi me energji elektrike - regjistri i tokave - librat amë (regjistrat e lindjeve, martesave dhe vdekjeve) - vulat doganore - trafiku ajror - pjesëmarrja e Kosovës në iniciativat rajonale
3	15 prill	<ul style="list-style-type: none"> - lëvizja e lirë - targat e automjeteve - njohja e diplomave
4	17 dhe 18 maj	<ul style="list-style-type: none"> - çështjet e kadastrit - lëvizja e lirë - çështjet e personave të zhdukur dhe të trashëgimisë kulturore - trashëgimia kulturore
5	2 korrik	<ul style="list-style-type: none"> - Marrëveshja për lëvizjen e lirë - Marrëveshja për regjistrin civil - Marrëveshja për regjistrat kadastral - Marrëveshja për njohjen reciproke të diplomave
6	2 shtator	<ul style="list-style-type: none"> - Marrëveshja për vulat doganore - telekomunikacioni - arsimi i lartë
7	28 shtator	<p>*Rundi i shtatë i bisedimeve, i cili ishte planifikuar për datën 28 shtator 2011, praktikisht u ndërpre për shkak se delegacioni i Beogradit refuzoi të vazhdojë me bisedimet, për sa kohë që Policia e Kosovës dhe doganierët e Kosovës kontrollojnë vendkalimet - temë për të cilën nuk është arritur një marrëveshje. Pasuan bllokada të vendkalimeve në Bërnjak dhe Jarinje.</p>

SHTOJCA 2 Marrëveshje teknike për lirinë e lëvizjes

e nënshkruar më 2 korrik 2011

- 1 Qytetarët të të dyja palëve duhet të kenë mundësi të udhëtojnë lirshëm brenda osse përmes territorit të njëra-tjetrës.
- 2 Secila palë do të zbatojë, sa më shpejtë që është e zbatueshme në aspekt operativ, një sistem të kalimit të kufirit/kufirit administrativ të qytetarëve të palës tjetër me letërnjoftim.
- 3 Secila palë mund të zbatojë një sistem ku letërnjoftimet do të shoqërohen nga dokumente me shkrim "hyrje-dalje" për personat nga pala tjetër të cilët dëshirojnë të kalojnë tranzit në një vend të tretë.
- 4 Si zgjidhje kalimtare, secila palë do t'ua mundësojë qytetarëve të palës tjetër blerjen e polisave të sigurimit kufitar/kufitar administrativ. Nën përkujdesjen e BE, palët do të vazhdojnë të punojnë për një marrëveshje komerciale për sigurimin reciprok të automjeteve ashtu që të gjitha automjetet në të dy anët e kufirit/kufirit administrativ të jenë të siguruar sa më shpejt që është e mundur.
- 5 Secila palë do të marrë të gjitha masat që t'ua mundësojë qytetarëve të palës tjetër të udhëtojnë lirshëm brenda dhe përmes territorit të njëra-tjetrës me patentshoferin e lëshuar nga autoritetet e veta.
- 6 Si masë kalimtare, autoritetet në Kosovë do të vazhdojnë vlefshmërinë e targave KS të automjeteve për një periudhë fillestare prej pesë vitesh në përfundim të së cilës çështja do të rishikohet nga të dyja palët (me lehtësimin e BE nëse kërkohet).
- 7 Të gjithë pronarët e automjeteve me vendbanim në Kosovë do të përdorin targat RKS ose KS (sipas pikës 6 më lartë). Ato do të lëshohen nga autoritetet përkatëse në Kosovë dhe do të shpërndahen me ndihmën e EULEX-it kudo që kërkohet. Secila palë do të bëjë përpjekje maksimale për të implementuar si më lartë.
- 8 Si masë e përkohshme, autoritetet në Beograd do t'ua mundësojnë automjeteve nga Kosova që bartin targat KS të qarkullojnë lirshëm në dhe përmes territorit të saj.
- 9 Si masë kalimtare, për cilindo pronar automjesh që dëshiron, do të vihen në dispozicion targa të përkohshme, në pikëkalimet kufitare/kufitare administrative.
- 10 Përkitazi me riatdhesimin dhe duke marrë parasysh obligimet e Prishtinës në këtë fushë, pikat e marrëveshjeve më lartë nuk do të krijojnë obligime për palën e Beogradit për të pranuar kërkesat për riparim për personat me dokumente të Kosovës në kuadër të marrëveshjes ekzistuese për riparim ndërmjet Serbisë dhe BE.
- 11 Një grup implemetues, i kryesuar nga BE, do të formohet nga mesi i korrikut për të siguruar që marrëveshjet e lartëcekura, së bashku me pika tjera përcjellëse, të zbatohen sa më shpejt që është e mundur nga aspekti operativ, pika 7 do të zbatohet nga 1 nëntori 2011.

SHTOJCA 3 Marrëveshja e Brukselit

(MARRËVESHJA E PARË MBI PARIMET QË RREGULLOJNË NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE)

e nënshkruar më 19 prill 2013

- 1 Do të krijohet një Asociacion/Bashkësi e komunave me shumicë serbe në Kosovë. Anëtarësimi do të jetë i hapur për çdo komunë tjetër me kusht që anëtarët janë në pajtim.
 - 2 Bashkësia/Asociacioni do të krijohet përmes statutit. Shpërbërja e Bashkësisë/ Asociacionit mund të bëhet vetëm me vendim të komunave pjesëmarrëse. Do të ofrohen garanci ligjore përmes ligjit të zbatueshëm dhe të drejtës kushtetuese (përfshirë rregullën për shumicën prej 2/3).
 - 3 Struktura e Asociacionit/Bashkësisë do të themelohet mbi të njëjtën bazë sikurse statuti ekzistues i Asociacionit të komunave të Kosovës, p.sh. Kryetari, Nënkryetari, Kuvendi, Këshilli.
 - 4 Në përputhje me kompetencat e parapara me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjin e Kosovës komunat pjesëmarrëse do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë në ushtrimin e kompetencave të tyre përmes Asociacionit/Bashkësisë në mënyrë kolektive. Asociacioni/Bashkësia do të ketë mbikëqyrje të plotë mbi fushat e zhvillimit ekonomik, arsimin, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural.
 - 5 Asociacioni/Bashkësia do të ushtroj kompetenca të tjera shtesë siç mund të delegohen nga autoritetet qendrore.
 - 6 Bashkësia/Asociacioni do të ketë rol përfaqësues te autoritetet qendrore dhe do të ketë një ulëse në Këshillin Konsultativ të Komuniteteve për këtë qëllim. Në përm-
- bushje të këtij roli është paraparë funksioni monitorues.
- 7 Në Kosovë do të ketë një forcë policore, e quajtur Policia e Kosovës. E tërë policia në Kosovën veriore do të integrohen në kornizën e Policisë së Kosovës. Pagat do të jenë vetëm nga PK-ja.
 - 8 Pjesëtarëve të strukturave tjera serbe të sigurisë do t'u ofrohet vend në strukturat ekuivalente të Kosovës.
 - 9 Do të ketë një Komandant Rajonal të Policisë për katër komunat veriore me shumicë serbe (Mitrovica Veriore, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi). Komandanti i këtij rajoni do të jetë një serb i Kosovës i nominuar nga Ministria e Punëve të Brendshme nga lista e ofruar nga katër kryetarët e komunave në emër të Bashkësisë/Asociacionit. Përbërja e PK-së në veri do të reflektojë përbërjen etnike të popullatës së katër komunave. (Do të ketë Komandant tjetër rajonal për komunat e Mitrovicës Jugore, Skënderajit dhe Vushtrisë). Komandanti rajonal i katër komunave veriore do të bashkëpunojë me komandantë tjerë rajonal.
 - 10 Autoritetet gjyqësore do të integrohen dhe do të veprojnë në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës. Gjykata e Apelit në Prishtinë do të themeloj një panel i përbërë nga një shumicë e gjykatësve serb të Kosovës për t'u marrë me të gjitha komunat e Kosovës me shumicë serbe. Një divizion i kësaj Gjykate të Apelit, i përbërë nga staf administrativ dhe gjyqtarë, do të vendoset në mënyrë të përhershme në Mitrovicën veriore (në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës). Secili panel i divizionit të mësipërm do të përbëhet nga një shumicë e gjyqtarëve serb të Kosovës. Gjyqtarët përkatës do të vendosen varësisht nga natyra e rastit në fjalë.

- 11 Zgjedhjet lokale në komunat e veriut do të organizohen në vitin 2013, me lehtësimin e OSBE-së, në përputhje me ligjin e Kosovës, dhe me standardet ndërkombëtare.
- 12 Një plan zbatimi, përfshirë afatin kohor, do të nxirret deri më 26 Prill. Parimi i financimit transparent do të adresohet në zbatimin e kësaj marrëveshjeje.
- 13 Diskutimet lidhur me Energjinë dhe Telekomin do të intensifikohen nga të dy palët, dhe do të përfundojnë deri më 15 qershor.
- 14 Është arritur pajtimi që asnjëra palë nuk do të bllokojë, apo inkurajojë të tjerët të bllokojnë, progresin e palës tjetër në rrugët përkatëse drejt BE-së.
- 15 Do të themelohet një komision zbatimi nga të dy palët, me lehtësimin e BE-së.

SHTOJCA 4 Aranzhimet lidhur me finalizimin e zbatimit të marrëveshjes për lëvizjen e lirë të vitit 2011 - bruksel 14 shtator 2016

- 1 Palët janë pajtuar që të mbulohen pjesët relevante të tabelave respektive të automjeteve me dy letërngjitëse të bardha.
- 2 Ky sistem me letërngjitëse do të hyjë në fuqi me 15 nëntor 2016.
- 3 Infrastruktura administrative për lëshimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme për regjistrimin e automjeteve me tabela të lëshuara nga autoritetet e Kosovës do të hyjë në fuqi në nëntor 2016.
- 4 Regjistrimi i të gjitha automjeteve me tabelat e lëshuara nga autoritetet e Kosovës (KS/RKS) do të fillojë më 15 janar 2017 dhe do të zgjasë për 12 muaj, në fund të së cilës periudhë do të ketë vlerësim nga të dy palët me ndërmjetësimin e BE-së.
- 5 Kosova do të zgjasë validitetin e tabelave KS për pesë vite në fund të së cilës çështja do të shqyrtohet nga të dyja palët (me ndihmën e BE-së nëse është kërkuar).
- 6 Përrjashtimet nga taksat dhe detyrimet për regjistrimin e automjeteve do të garantohet nga Kosova në të njëjtën mënyrë sikurse në rastin e kaluar. Bashkëpunim i ngusht dhe i shpejtë do të vendoset në mes të dyja palëve për të verifikuar pronësinë e automjeteve. Regjimi i ngjitjeve do të hyjë në fuqi më 15 nëntor 2016.
- 7 Një fushatë informuese për tu`a shpjeguar banorëve të afektuar modalitetet për ri-regjistrim të automjeteve do të ndërmerret nga të dy palët dhe BE-ja. Diskutimet e mëtejshme mbi fushëveprimin dhe modalitetet e fushatës së lartëpërmendur do të diskutohen në grupin për zbatim.
- 8 Tabelat e veturave që preken nga procesi i regjistrimit nuk do të afektohen nga sistemi i letërngjitëseve.
- 9 Për shkak të ndjeshmërisë ndërlidhur me pikat e lartëpërmendura, palët janë pajtuar të që shqyrtojnë zbatimin e këtyre konkluzioneve në një interval kohorë prej tremuajsh.

Iniciativa Open është e përkrahur nga KFOS

